

VENDIM
Nr. 43, datë 27.11.2015

**PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTET E PROGRAMIT TË
INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, ME AVANCIM PUNIMESH,
NGA FONDI PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, "Për buxhetin e vitit 2014", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Financimin e projekteve të programit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, me ecure punimesh mbi financimin e miratuar të vitit 2015, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, me burim financimi Fondin për Zhvillimin e Rajoneve, programi i infrastrukturës vendore dhe rajonale.

2. Të gjitha autoritetet kontraktuese me projekte të financuara sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të paraqesin rregullisht pranë Sekretariatit Teknik, në Ministrinë e Zhvillimit Urban, informacion për ecurinë financiare të disbursimeve të projekteve, të shoqëruar me dokumentet përkatëse.

3. Ngarkohet Sekretariati Teknik, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, të bëjë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas dokumentacionit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
EDI RAMA

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar.

Tabela 1. Lista e projekteve të infrastrukturës vendore (cikël financimi 2015-2016), me avancim punimesh

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e kontratës (në lekë)	Vlera e financimit të miratuar për vitin 2015 (në lekë)	Fonde që i shtohen financimit për vitin 2015 (në lekë)
	QARKU BERAT				

1	Bashkia Berat	Rikualifikim dhe rikonstruksion i Parkut Dëshmorët e Kombit, trotuareve dhe unazës perimetrale	81,232,082	56,950,346	14,000,000
2	Bashkia Kuçovë	Rikonstruksion i rrugës “Qemail Stafa” dhe “Kristaq Lacka”	140,043,456	67,646,995	72,396,461
QARKU DIBËR					
3	Bashkia Bulqizë	Pedonalja e qytetit dhe Unaza e Poshtme	101,550,698	72,535,441	29,015,257
4	Bashkia Burrel	Rikonstruksion i fasadave dhe zëvendësimi i ndriçimit në rrugët: “Koke Malci” – Qendër – “Rexhep Pashë Mati”, “Kuvendi i Dukagjinit” dhe trotuaret për rrugën “Kuvendi i Dukagjinit”	49,885,328	46,555,875	3,329,453
QARKU DURRËS					
5	Bashkia Durrës	Rikonstruksion i pishinës publike	39,600,120	35,000,000	4,600,120
6	Bashkia Durrës	Rikualifikimi i fasadave në qytet	74,413,260	75,629,876	(1,216,616)
7	Bashkia Durrës	Rrugë mbi kanalin kullues, K-192, Plazh, Loti I	73,622,568	67,088,718	6,533,850
8	Bashkia Fushë-Krujë	Rehabilitim i fasadave të qytetit Fushë-Krujë	28,361,084	20,111,033	8,250,051
9	Bashkia Shijak	Rehabilitim i qendrës së qytetit të Shijakut	90,837,938	68,737,480	22,100,458
QARKU ELBASAN					
10	Bashkia Elbasan	Sistemim asfaltim i rrugës “Nusret Kokobobo” dhe i shesheve të pallateve (60,61,62,63/1,64/3), lagjja “Emin Matraxhiu”, Elbasan	41,979,166	29,976,831	12,002,335
11	Bashkia Elbasan	Sistemim asfaltim i rrugës te pallati i sportit	35,002,096	26,177,815	8,824,281
12	Bashkia Elbasan	Sistemim i rrugës “Marie Dhama” dhe sheshet e pallateve	22,800,000	16,790,306	6,009,694
13	Bashkia Elbasan	Suvatim dhe lyerje fasadash në rrugët kryesore për 100 banesa kolektive	131,251,597	96,083,743	35,167,854
14	Bashkia Gramsh	Rikonstruksion i fasadave dhe sheshit qendror të qytetit, Bashkia Gramsh	27,309,848	27,999,467	(689,619)
QARKU FIER					
15	Bashkia Lushnjë	Rehabilitimi i fasadave në qendër të qytetit dhe rruga “Misto Mema”	20,458,020	12,234,212	8,223,808
16	Bashkia Lushnjë	Urbanizimi i zonës informale në lagjen “18 Tetori”	87,917,664	64,885,279	23,032,385
QARKU GJIROKASTËR					
17	Bashkia Tepelenë	Restaurim i fasadave, ndriçim, sistemim trotuaresh	84,159,869	62,650,000	13,093,882
QARKU KORÇË					
18	Bashkia Ersekë	Rikonstruksion i sheshit, faza e 2-të, Ersekë	9,500,000	7,600,000	1,900,000
19	Bashkia Maliq	Rikonstruksion i çative dhe fasadave të objekteve në rrugën kryesore, qyteti Maliq	41,850,051	37,385,449	4,464,602

	QARKU LEZHË				
20	Bashkia Lezhë	Zgjerimi i urës së Lumit Drin, dekorim dhe ndriçim	90,134,636	64,198,350	25,936,286
	QARKU SHKODËR				
21	Bashkia Shkodër	Rikualifikim urban i rrugicave në qendrën historike Sheshi Gjon Pali II	16,345,928	14,495,306	1,850,622
	QARKU TIRANË				
22	Bashkia Kavajë	Rruga e daljes (zona industriale), rikualifikimi i plotë, (trotuar, asfal etj.), faza II	94,630,601	70,000,000	24,630,601
	QARKU VLORE				
23	Bashkia Sarandë	Rikonstruksion i Rrugës së Fermerëve, fshati Metoq	45,213,415	26,000,000	19,213,415
24	Bashkia Selenicë	Rikonstruksion i fasadave dhe gjelbërimi i ambienteve përreth pallateve përgjatë bulevardit “21 Shkurti” në qytetin e Selenicës	30,228,991	21,694,833	8,534,158
25	Këshilli i Qarkut Vlorë	Pikë turistike vrojtimi në Porto Palermo	573,600	456,236	117,364
	TOTALI		1,458,902,016	1,088,883,591	351,320,702

Shënim:

1. Vlera e kontratës” përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoritetit kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit, të kërkuar për financim nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Vlera e kontratës përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban).

2. “Vlera e financimit të miratuar për vitin 2015” tregon vlerën e financimit që u vu në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, që miratuan financimin e objektit.

3. “Fonde që i shtohen financimit” për vitin 2015 tregon vlerën e fondit të shtuar, mbi financimin e miratuar deri tani me vendime të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, gjatë vitit 2015, për objektet që kanë ecuri punimesh mbi vlerën e financimit të miratuar në vendimet e mëparshme të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2015. Kjo vlerë pakëson vlerën e mbetur për financim në vitin 2016.